

BIBLIOTEKA

E

SHTETI

SPIRO GJIKONDI

8 JH - 1

873

GJIROKASTEL

Përmes
Vitave

Vjersha

891.983-1

3

8973

SPIRO GJIKONDI

PERMES VITEVE

(Vjersha)

~~55800~~

12500

B.BLOQILKA E SHTETIT
GIROKASTER

M A R S H I M .

Përmbi supe pushkët mbanim;
si shqiponja malit ngjanim
ecnim, ecnim, s'ndalnim, s'ndalnim.

Rridhnin djersët, rridhnin ballit.
ecnim shpatesh, majës malit
këmbët shkelnin fije bari.

Qielli nxinte pus i thellë
ne kalonim buzë humnerës
gjoksin vinim përballë erës.

Përmbi krahë çantat hedhur
përmbi brez gjerdanët ngjeshur
shallin qafës, buzëqeshur.

Pushkët mbanim përmbi supe
ecnim, ecnim gjithmonë tutje
drejt agimesh, buzë muzgjesh.

Përmbi ballë yjet ndrinin
Rreze dielli gurash pinim
shtigjesh ecnim, shtigjesh prinim.

PIANISTES ME UNIFORMË USHTARAKE

Rrëshqisnin gishtat lehtë mbi tastjerë
dhe flokët valaviteshin mbi supe
këpuc' e rëndë pedalin shkelte pa ndërprerë
një marsh i lehtë hapsirën plot e mbushte.

Më ngjante melodia me këngët partizane
me krisma të egra pushkësh në luftime
me vërvhellimë ere, suferine, tramundane
me cicërim'n e zogjve ndër agime.

Ish ulur rrëth teje e dëgjonte kompania
pa marrë frymë e sytë nuk t'i shqiste
dhe unë me ty pranë sikur bridhja
betejave kur flaka errësirën digjte.

TË SHTATË

Dëshmorëve të fshatit tim.

Të shtatë pinin ujin e një kroi
sikur të pinin sisën e një nëne
të shtatë pinë ujë Lizikoi
kur morën malet atë mbrëmje.

E egër frynte era që nga malet
dhe retë hidhnin shi e breshër
por shndrisnin yje edhe zjarre
mbi majën e Çukës zhveshur.

Dhe ikën. Eh, sa rrugë brodhën
të shtatë nëpër male e kodra...
diku një valle burrash hodhën
një valle sa u tund toka

diku barkas u shtrinë në llogore
me qytën e pushkës nën faqe
që dimrit të shkrinte dëbora
e maleve të mbijnë manushaqet.

Dimret ishin të akullt, të ngrirë
por zemrat e tyre të ngrohta
dhe, kur mbetën mbi akullin shtrirë
si nënë në gji i mbështolli toka.

Dhe erdhën përsëri në fshat
me yjet e ballit të ndezur
me pushkët hedhur krahëqafë
me bomba e gjerdanë ngjeshur;

në rrjeshta mes shokëve erdhën
duke kënduar një këngë partizane
nëndorit kur fletët po binin
e ujët gjëmonte n'ujvarat.

Të shtatë vijnë shpesh në agime
e ndalen nën hije të rravit
dhe pleqtë i puthin mbi thinja
të shtatët bij të fshatit.

SIMFONIA E JETËS SONE

Simfonia e jetës
u shkrua në rrugë të hekurta
simfonia e jetës
u shkrua mbi tela tensioni të lartë
buroi nga zemrat e ndezura
në ditët e netët e bukura shqiptare;

simfonia e jetës
buroi nga gurrat popullore
si këngë e moçme kreshnikësh
për ditët e reja plot diell
për fytyrat gazmore të të rinjve
për vitet ngarkuar me epikë;

simfonia e jetës
ushtoi në skena masive
të fushave të gjera me grurë e në male
si ujërat kristalore mes shkëmbinjve
si shkumë e bardhë në diga çentralesh.

U ndie nga skaji në skaj mes luginash
nën gishtat e trashë
të punëtorit, fshatarit
u shpleks si flamur mes suferinash
si mendim i ri
në oxhakun e shtëpisë së re të malësorit.

Simfonia e jetës endet mbi punën
e në këngët për punën
mbi dashurinë e re
e mbi këngët e dashurisë së re
që buçasin nga radiot e altoparlantët
bulevardeve e rrugëve, agimeve e mbrëmjeve. . .

S O N J A

Ti, Sonja, po shfleton librat sot
edhe një tufë lulesh mban në dorë,
çantën e ke mbushur plot
me libra, bojë, laps dhe fletore
E buzëqesh si lule

buzëqeshje trëndafili.

Kordelja, lidhur përmbi flokë, ngjyrë qielli.
Ke emocion, e gishtat po të dridhen
për dore më tërheq:

«Më shpejt, xhaxhi, vajti vonë».

Nga era flokët lart të hidhen.

Drejt shkollës ecën
sikur fluturon.

2

Po të përcjell...

dhe një mendim ma rrudh sot ballin.

Ti s'më kupton

vërtet nuk ke se si e di.

Të shoh si ngjitesh shpejt në shkallë,
e buzëqesh
e s'flet,

(të kam zili).

Dikur, kështu si ti, e nisa shkollën,
por isha vetëm

njeri s'më shoqëronte,
im at gjithë ditën ndreqte shollë,
im më, që natën, ish ngritur të lëronte...
Ti me kordelë flokët i ke lidhur,
je krehur mirë,
e ke fustan të bukur.

Ndërsa, kur shkoja unë, gëlltisja lot të hidhur
se këmbët hidhja zbathur përmbi pluhur.

Ti do të shkruash «A»-në lehtë-lehtë.
Dhe do të hapin portat gjithë dijet
do të mësosh si rriten pemët fletë-fletë,
si ndizen dhe si fiken gjithë yjet.

Po hyn tashti në botën plot me shkronja
më pas-ne numra, formula e në ligje,
dhe po të shoh që sot n'auditore, Sonja
me një projekt në dorë shkallëve tek ngjite.

TI NGELE NË KUJTESËN TIME...

Për një ditë aksioni në
Llakatund, ku mbollëm 20000
fidane plepi.

Ti ngele në kujtesën time
si një kujtim i çmuar:
një peisazh dimëror fshatarak
me plepa të zhveshur
pranë arave, që prisnin farën e grurit
me rrugët e ngushta plot baltë;
ti ngele në kujtesën time
me agime të kaltra,
me ditë plot re
e shi
me muzgje të hirta
e suferina
me mbrëmje të qeta
e zemra të yakëta,
ngarkuar me cicërimë.
Më ngeli në kujtesë ajo dëtë dhjetori...

kur daullja na zgjoi me natë.
Uturonin maqinat.
Gurgullonte Shushica e egër
sikur të këndonte një këngë aksioni
me pëshpërimën e saj të vjetër...
dhe vajzat me kazma
 me çizme
 e tuta
me sytë të ndezur
 nën tinguj gërneta
si karvan i gjatë vraponin
 mes fushës
të ambillnin bri lumit
 fidane e plepa.
Fenerët aty-këtu
 ndriçonin në rrugët e pjerr'a
si një grumbull i madh xixëllonjash
dhe më ngjante se kish ardhur pranvera
e pemët
 kishin nisur të lulëzonin.

M E R S I N I

Shtëpinë Mersinit
aty në breg të Shushicës
ja dogjën gjermanët
ja dogjën
sepse shtëpia ish fole partizanësh
por duart s'ja dogjën Mersinit
nga koka dot s'ja rrëzuan qylafinë.

2

Lëpinte era atë mbrëmje flakët,
tek binin drunjtë e tjegullat me zhurmë
dhe shkrepat u skuqën
dhe u skuq qielli i kaltër,
dhe nxihesh muri i gurtë, i murmë.

Si ikën gjermanët
pas lanë flakë
dhe shkrumb.

Po digjej shtëpia
dhe zemra i digjej Mersinit.
Shtrëngonte grushtet fort
në xhepet e potureve të tija
dhe sytë i mbante tej
nga majë e Çipinit...

ku digjeshin zjarre në male,
ku nata me vellon e saj po mbështillte
dhe zjarre
dhe marshe
dhe këngë partizane
dhe gurgullimën e Shushicës që rridhte.

Ahere vrapi Mersini
nga kodra në kodër
dhe fort në sup shtrëngonte dogranë
I rrihte e i gjëmonte
në gjoks zemra si lodër
tek dëgjonte që larg
ushtimën e këngëve partizane.

Dhe sytë i shkëlqenin.
Yjet qielilit nata kishte ndezur

e tundeshin pemët nga era e vërshëllenin
në shpatet e pjerrëta,
në shpatet e zhveshura.

5

Vraponte e vraponte Mersini
më shpejt s'kish ecur asnjëherë
më shpejt s'ish ngjitur majës së Çipinit
hidhej e fluturonte si erë.

Kalcat e lashta zbardhnin mbi gurë
e sharku nxinte bogave të bardha;
ecte Mersini pa u ndalur
me sytë lart në majë...

TE BARINJTË

Mbrëmë fjetëm majë malit, në kasolle.
Miqësisht na priten barinjtë,
na shtruan të hamë në një çetur dhalle,
na mbuluan me një llabane të dhirtë

na dhanë dhe sharkun e zi,
E «shtratin» na i ngritën pranë zjarrit.
Se jashtë fryntë erë e binte shi
sikur të ish në mes të janarit.

Si mbrëmjet partizane kaluam atë natë
(Ne ishim ushtarë të një garnizoni
me vete kishim karabinat dhe kundragazin.)
Barinjtë episode nga të luftës na tregonin.

Gjithë natën shiu rrëshqiti mbi kashtë
gjithë natën era vërshëllente në hone

12593 55000

gjithë natën qentë na lehën që jashtë
dhe delet në shtrungë tundnin këmborët.

Ne ishim të lodhur dhe fjetëm të qetë.
Barinjtë nuk reshtën së hedhuri dru zjarrit
ata shikonin tek ne bijtë e tyre
e ne tek ata shikonim baballarët.

PENTAGRAMET E METALTA

Këta tela që kryqëzohen mbi kurorat e maleve
më ngjajnë me pentagrame

në një sfond të bardhë
pentagrame të pafundta
mbi grunajat e gjelbëra,

mbi shpatet e egra,
mbi tarracat radhë-radhë.

Me notat më ngjanë llambat dhe izolatorët.

Me notat më ngjajnë hëna dhe yjet e zjarrita
kur mbrëmjeve dalin

mbas kreshtash shkëmbore
kur zënë e rrëshqasin mbi fijet e metalta
dhe rri e kundroj në mbrëmje

gjer vonë,
si zgjaten këto pentagrame në pafundësi
dhe ndjej si luginave ushtojnë:

Buçima ujvaresh,
turbinash;

reflekse llambash
e yjesht

e këngët e punës
në rrugët e fshatit të ri.

NATA E SHËN BARTOLOMEUT

Ti ecën nëpër vite, shën Bartolome
si një mantel i shpuar nga thikat
na shpleksesh fletëve të historisë si një re
që pikon gjak tek ikën.

E «shenja» natë... e pahuar
e tmerrshmja natë, shën Bartolome
në kolivistër gjak... në gjak je pagëzuar
me kryq.
Për kryqin more emrin «Shën Bartolome».

Për kryqin
rrugëve të Parisit binin kokët e përgjakura
dhe skuqnin kamat tehbardha
ndërsa në Romë rrinte Papa i spërkatur
me yje qielli supeve e fishekzare.

Dhe ecën nëpër vite, shën Bartolome
si një mantel i shqyer nga thikat;

na shpleksesh
fletëve të historisë si një re
që pikon gjak tek ikën. . .

Eh, nëna ime se ç'pat ngjarë s'dinte.
Kur i tregova
se sa gjak u derdh atje
drejt qellit, ajo zërin e ngriti:
— Mallëkuar qofsh, Bartolome! —

Bërtiti: — Zot, ku ishe atë natë?
Për tridhjetë mijët si s'të erdhi keq?
Në qofsh
dhe vetë i le të nxjerrin shpatat
mallëkuar qofsh dhe ti, që hesht.

NE UZINEN E TRAKTOReve

Këtu çdo gjë është metalike
dhe syri ngado që e hedh të ndesh në metal.
Në veshë gjëmon zhurma e çekiçëve pneumatikë,
si një melodi me akorde të vrazhda.
Këtu metali derdhet i kuq
i zjarrtë i shkrirë...
Këtu syri të ndesh në pistone
në kazma në plugje
Eh! Nëna ime që punon nëpër lugje
vajtonte gjithmonë për një kazmë të tillë...
për një bel humbiste sa ditë
dhe ikte nga fshati
në Sarandë Delvinë
ndërsa fara të mbillej priste

ndërsa ara në fushë
mbetej djerrinë...

Këtu është çdo gjë metalike,
dhe syri,
ngado që e hedh
të ndesh në metal.

Dhe ndjej
si më vjen nga larg
përmes brigjesh
zburma e traktorit
që lëron diku në një arë.

Dhe para më del
filizi i grurit të mbirë
që rritet i gjelbër
ngadalë nën borë
tek rri përpara metalit të shkrirë
këtu
në uzinën e traktorëve.

P A R T I

Rrugëve të gjata nuk më lë të vetëm.
Rrugëve të gjata, të vështira
ti m'u ndodhe pranë gjithë jetën
si udhërrëfenjëse nëpër mjegulltirë;

ti më ke mbuluar si një nënë e mirë
netve të ftohta, netve me ngricë
me një shark të leshtë, me qilim të dhirtë
ti më ke mbuluar me jorgan të ngrohtë;

ti më shtrive krahun, në këmbë më ngrite
kur më shkau këmba dhe desh u rrëzova:
«Ja ku është rruga, zgjidhe të mos vritesh
mbahu, bir i dashur» — zërin tënd dëgjova.

Sisën tënde piva dhe shova urinë,
sisën tënde piva edhe shova etjen...
për ty do ta falja gjithë djalërinë
që ti nën' e mirë të jetosh në shekuj.

VAJZA E 180 DETALEVE

Diku e kisha parë atë vajzë të zeshkët...

Ndoshta në postë

duke folur me të fejuarin ushtar

Ndoshta para fakultetit

me libra nën sqetull

Ndoshta me çantë nëpër pazar...

Dhe prapë sot mbi torno e pashë

me flokët mbështjellë mbas kokës

me pantallona plot vaj e plot graso

me buzëqeshjen e saj

të zakontë.

Dhe desha për të ca vargje të shkruaj

dhe desha

t'ja bëj portretin të thjeshtë

por emrin dot s'ja mësova...

Si quhej..?

Dhe si ta quaj unë në këtë vjershë

atë tornitoren me fytyrë të zeshkët

që me duart e saj të vogla
punonte me shkathësi
në tetë orët e punës
njëqind e tetëdhjetë detale
aty në repartin e tornerisë?
Le të quhet pra vajz' e detalete
në vargjet e mia të thjeshta
ajo vajza e re me sandalle
ajo tornitorja me fytyrë të zeshkët.

FSHATARËT Ë MI

I njihni ju ata
të gjithë ju i njihni.
Me dhjetëra, qindra herë i keni parë
kur çdo të diel fiq të tharë shitnin
në ndonjë qoshe thellë në pazar

i keni parë kur në det rrugët nisnin
dhe linin pas shtëpinë gjithë mall,
kur pash më pash rrugët e botës matnin
gjithë jetën mbushur plot me halle.

Në ato rrugë të pafundme ngeli gjyshi
(në ato rrugë ngeli gjyshi im i mirë)
kur vagonetat shtynte thellë galerive
nëpër minierat e qymyrit mbeti shtrirë.

I patë kur u nisenë nëpër male
me torbat hedhur krahut plot fishekë,

kur kokën e mbështetnin ndër llogore
dhe syrin e tendosnin mbi shinjestër.

I shihni shpejt pa dalë yll' i dritës,
pa zbardhur mirë majë e Pyhoit
kur qetë mbrehin heshtur në tevligë,
kur torbat, gunat i lenë poshtë ftoit

kur ulen këmbëkryq mbi plisa e mbi gurë
e tjerrin diskutime mibrëmjeve të verës,
flasin për të korrat, misërin e grurin,
për Diellin, për Hënën, për Marsin e Venerën.

I njihni ju ata, të gjithë ju i njihni
me dhjetëra, qindra herë i keni parë;
në poezitë e mia përherë do t'i shihni:
punëtorë, të urtë, të dashur, luftëtarë.

K E N G E T O R I

Ish i thatë e ish i thinjur
këmbëzbathur, zhele veshur
ish i plakur, i uritur
i pastrehë e buzëqeshur;

pushkë s'kishte hedhur krahut
brezit s'kishte varur bomba
por me këngët ndizte zemrat
armë — këngët që këndonte;

ecte rrugëve e këndonte
jeta e tij buronte këngë
këngë brengash, këngë lotësh
këngë vuajtjesh të rënda.

Këngë malli, dashurie
rridhnin, rridhnin nëpër buzë

rridhnin vite djalérie
nëpër tinguj si tärkuzë.

Dilnin gratë dhe dëgjonin
rreth i mblidheshin fëmijët;
yjet qiellit xixëllonin
dilte hëna tej në brinja

dhe mbi rrugët derdhte rrezet
dritë të mekur mbi kalldrëme.
Këngëtari ecte, ecte
dhe këndonte këngë, këngë...

Ngryste ditët nëpër rrugë
gdhinte netët e acarta
tirrëtë këngët si në furkë
këngë t'ëmbla, këngë mjaltë.

...Ishte dimër. Ftohtë. Mbrëmje.
Në kraharorin e rreckosur
ndjeu takën e çizmes rëndë...
(Taka e çizmes ish gjakosur...)

Edhe ra mbi trotuar...
Gjoks' i tij shpuar nga plumbat...

Në çatitë kishin ndalur
së gugaturi pullumbat.

Çizmja rrugëve trokonte
ngrihej «Alti» përmbi këngë
që nga gjoksi gjaku i rridhte
dhe pikonte mbi kalldrëmë...

Rridhnin strofat që nga zemra
skuqur gjakut përmbi gurë
edhe nisnin rrugët e gjata
shmpleksnin udhët si flamurë.

Dhe i gjeje në çdo lagje
i dëgjoje në çdo rrugë
të rënda si këngë labçë
të kuqe si gjak flamuri.

I këndonin partizanët
në marshim e në llogore
kur mblidheshin rrëth zjarrit
mbas betejës, mbas fitores.

Me shirita këngësh lidhnin
plagët e trupit që kullonin...
dhe s'e ndjenin ata dhimbjen
këngët plagët i shëronin.

Dhe me këngët këngëtori
ngjitej majave të larta
përmes erës, përmes borës,
zbriste fushave të arta...

Vërtet pushkë s'kishte krahut
brezit s'kishte varur bomba
por me këngët ndezte zemrat
armë — këngët që këndonte.

PERËNDITË NË AGONI

Në qiellin tonë u endën perënditë
si re të murme e korba të zez.
Me sqepa të mprehtë notonin xhamitë
me mjekër si fshesë, të zez priftërinjtë.

Por u ngritëm të gjithë një ditë,
në ditët e ftohta të shkurtit
dhe s'ditën ku të futen perënditë
e mendjen e humbën dhe rrugën

dhe ranë në prita e u zunë në leqe
me grahma, me plagë e me thirrma
dhe ndjenë goditjen e fundit për vdekje
sikur të qëllonte në to vetëtima.

E prapë në ndërgjegjen e plakut të moçëm
Jezui i mbërthyer akoma merrte frymë

me fasha të reja mjergulle, tymi
lidhte plagët e hapura në gjoks e në brinjë.

Dhe shfaqej aty-këtu në gjumë e në ëndrra
i tmerrshëm, me shpatë e me kamë në brez
dhe gjumin e émbël sikur shponte me gjëmba
e zhdukej sa binte drita në mëngjez.

Por ne prapë në prita e prapë në luftë
i dalim përballë Jezuit të mbërthyer.
Dhe dridhet Jezui e s'ka ku të futet
në agoni përpëlitet si bishë e ndërkryer.

ASAJ NATE

*Kushtuar
Isuf Emin Pllocit*

Telat e tensionit ishin të kuq
asaj nate

telat ishin të nxehur
sikur të dilnin
nga gjoksi yt, çë kishte marrë flakë
sikur të dilnin
nga zemr' e zjarrtë e Prometeut;
dhe çanin aty-këtu

nëpër fshatra

e ndizeshin llambat nën tavane
ndërsa nënrat
kishin ndezur zjarret në vatra
dhe dëgjonin

lajmet që jepte Tirana...

Ahere u dukën konturet e trupit tënd të ndezur
aty përmes urëve.

Dhe ne i zgjatëm papandehur
drejt flakëve

pëllëmbët e duarve...

sikur të donin

nga flokët të të nxirrnin

sikur të donin

flamur mbi flakët të të ngrinin.

MINARJA E XHAMISE

Në një pllakë

në derën e xhamisë

lexova:

«Monument kulture, mbrohet nga shteti»

Minarja pingul;

Përreth heshtje.

Mendova:

— Kjo minare

mbi kokën e xhamisë

si një qiri i fikur

mbi varrin e një të vdekuri.

VARGJET E MIA

I desha gjith' vargjet që shkrojta dikur,
i desha, i dua;
i shkrojta në arat e mbjella me grurë
mbi gjunjët e tua;
me gjethë të gjelbërta pemësh i mvesha
me lule i stolisa;
me krehër të dendur borigash i kreha
me bar i qëndisa
me ujë shiu në dimër i lava
me ujë të pastër
me rrezet e arta të diellit ç'i thava
me erën e vakët;
i shkrojta kur pushonim në vapë
bashk' me fshatarët,
kur ngisja mbas qeve, i mbaja në buzë
kur çaja ugarët;
prandaj gjith' vargjet që shkrojta dikur
i desha, i dua,
strofat si kallzat me grurë i shkërmiq...
aty nënë ftua...

SA TË DUA TY, MOJ NËNA IME...

Sa të dua ty, moj nëna ime...
Kush si unë, vallë, nuk e deshi nënën
kush, vallë, s'i deshi nënënat tonë trime
që i gdhinin netët përmbi lëmë..?

Që mbi supe peshë e mbajtën gjithë jetën
si një thes të rëndë mbushur me halle
që punonin arat për të tretën
dhe e derdhnin djersën mbi ugare?

Nënënat tonë plaka, fytyrëzbeta
që na lindën brazdave mbi tokë
që na lidhën me fashqe të leshta,
dhe na rritën me pak qull të ngrohtë?

Kush s'i deshi, vallë, nënënat shamizeza
që shikimin tretnin përtej deteve

në muzjet e përhimta të rivierës
për burrat q'ishin larg kurbeteve?

Kush s'i deshi nënët që s'pyetën
kur i nisën bijtë lart në male
kur bijtë edhe bijat falën jetën
për çështjen tonë të bukur e të madhe?

Kush s'i deshi nënët flokëhirta
që i gdhinin netët në bodrume
me bijtë që nga plagët gjaku u rridhët
ndërsa jashtë frynte era dhe furtuna?

Eh, moj nënë, ç'gjëra do të thoshja
të isha pranë teje këtë mbrëmje
do të thoshja, nënë, sa të doja,
do të thoshja sà të dua, nënë.

Unë jam larg e më merr malli mua.
Sa kam mall të rri pak çaste pranë teje
të të them sa rrugë kam kaluar
të të them se ç'vrull që kam në deje;

pak çaste përmbi gjunjë të mbështetem,
të më ledhatosh me duar plot damarë,
të më këndosh një këngë si ahore
kur isha fëmijë. Disa vjet më parë...

XHORDANO BRUNOS

Ti ishe i vetëm, Xhordano, i vetëm
aty mbi turrën e druve.
Njerëzit rrëth teje qëndronin të heshtur
me lot në cepat e syve.

Mbi ty
veç yjve e reve nuk endej asgjë
por rrrotull mbi kokët e tyre qëndronte
parajsa dhe zoti e frika e ferri
qëndronin kasapët shënktorë.

Dhe në vetëminë tënde flaka të përpiu
e humbe në çast... mes prushit.
Ra shi dhe hirin thithi dheu
në atë perëndim të shtatëmbëdhjetë shkurtit.

E rodhën vitet përmbi ty, e shekujt
me lot e dhimbje të mbuluan.
Kur të kujtojnë, dridhen kishat, tempujt
se emri yt
me flakë në qiell u shkrua.

MENDIME NË VENDROJE

Mbi supe mbaj kapotën e ushtarit
në zemër ndjenjën time poetike
që ndizet zjarr në netët e janarit
pranë topave me gojët metalike.

Këpucët mbajnë baltën e transheve
këpucët mbajnë baltën e ugareve...
dhe më kujtojnë ditët kur mbas qeve
lëshoja kokrra-kokrra farën e arave.

Dhe më kujtohet nëna flokëbardhë
kur rrinte natën vonë pranë zjarrit...
(Dhe sonte ndoshta mendon vallë
mendon për mua ndoshta, për ushtarin.)

Nga jugu e ka nisur vrapiin era
në buzë m'i kap vargjet, posa dalin

dhe i flet nënës lehtë që nga dera:
— Mos u mendo! Si molla e ke djalin. —

E nëna buzëqesh...
me mashë mbulon shpuzën;
fik dritën...
Unë tytën, bajonetën prek
për qafe marr «mortajën» dhe «obuzin»
dhe hedh vështrimin tutje përmbi det.

M B R È M J E

Ja, po ikin tutje nëpër gryka retë
yjet ulen një nga një mbi majë
dhe me yjet nata ulet qetë-qetë
e mvesh plepat, ahët e dushkajat;

mvesh çdo gjë përreth, edhe ndërtesat
ku mbi shtretër çlodhen minatorët...
Gurgullim' e lumiit ndihet midis shkrepash
si një këngë e egër burrërore.

Vendi ndizet. Dhjetëra llamba shndrisin.
Tej maqinat duken në çdo kthesë.
Qetësinë e mbrëmjes zhurmët shkelin, grisin
era pluhurin e rrugës fshin me fshesë.

S H O F E R I T

Për N. M.

Sa herë në maqinën tënde hipin minatorët
të flasin miqësish. Me dashuri u flet
përherë u buzëqesh, u shtrëngon dorën.
Kush nga punëtorët vallë ty s'të përshëndet?..

Ti rrugët njeh pëllëmbë për pëllëmbë,
mos vallë rrugët nuk të njohin ty...?
Mbi to maqina jote ecën rëndë-rëndë
mbi to maqina jote shket me shpejtësi.

Diku të pret një furrë, një kaldajë
andaj pranë bunkerit shpejt e shpejt ngarkon.
Në ballin tënd shkëlqen djersa dhe vaji
mëngjezi dhe mbrëmja të gjen mbi timon.

NË RETINËN E SYVE

Kur jemi pranë njëri-tjetrit të dy
në retinën e syve të tu shoh veten time
dhe ti, si para pasqyrës
kreh flokët e tua, bjondinë
në retinën e syve të mi.

NË SHTËPINË E PUSHIMIT

Ndihet shushurima e pashtershme e valëve
e në xhame një e trokitur e lehtë
— Hyrë!

Jam vetëm me këngët e tua.

Hyrë! —

Hap dritaren...

Zhurma e dallgëve mbush dhomën e heshtur.
Kaltërsia me shiritë të bardhë valësh
si fustani që mbaje ti dikur.
Era e detit fryn mbi fletët me vjersha...

KËNGA E TË INTERNUARVE¹⁾

«I rrrethuar me tela si një zog
Dhe gjermanin, që bën roje, s'e
shoh dot».

Nga një këngë popullore

C'më ndezi në këtë mbrëmje
kënga me iso të zgjatur...
ç'u kujton, ç'u sjell në mendje
baballarëve të mplakur?..

Dikur shtypur, zbathur, zhveshur
dikur këmbët skuqnin gjak.
Era borë hedh pa reshtur
mbi çatitë e prak më prak.

1) Kushtuar të internuarve nga bregdeti nëpër kampet naziste, nga të cilët vetëm një pjesë e vogël shpëtoi dhe u kthyte në atdhe.

Dikur çizmja trokëllinte
nëpër rrugë e derë më derë
si një gur që rrapëllinte
hedhur thellë në humnerë.

Në oborre ulërinin
gratë me fustane zvarrë.
Burrat iknin. Ku i shpinin
lidhur duart me zinxhirë?

Larg atdheut. — Mos vajtoni
do të vijmë përséri.
Dhe në vdekshim do të thoni:
Ranë, ranë për liri —

2

Në një qafë përmes telash
varre... varre... I varrosën.
kush nga burrat atje mbeti,
dhe sa zemra u vrerosën?

Dhe sa lot për shokët shndritën,
shndritën syve e faqesh ranë?
— Hej, o shokë, — mos vajtoni
dëgjoni në mal dogranë.

Majë malesh shkrepnin yjtë
retë zbrisnin në rrëpira
Shqipëria qante bijtë
faqe-çjerra, shaminxira.

Qante, çirrej edhe ngrihej.
Mbi të shndritte bajoneta;
nëpër qiell kryq' i thyer
nxinte, nxinte posi netët.

Toka flakë e toka djegur
gurët skuqnin, skuqnin gjak,
— zemra jonë skuqur, nxehur
posi hekuri mes flakësh.

Kur shtëpitë merrnin flakë
kur në male binin trimat
kur me këngë partizanët
hidheshin si vetëtimat

pas lamë nënët, pas lamë gratë,
lamë fëmijët të uritur
ikëm rrugëve të gjata
larg atdheut duarlidhur.

Larg atdheut. — Mos vajtoni!
Do të vijmë përsëri.

Dhe në vdekshim do të thoni
Ranë, ranë për liri.

3

... Ja dhe burgjet, ja dhe kampet
ja liria kullon gjak,
dilni, shokë, merrni malet
po ju flasim që nga larg.

Përtej telash shkrep liria,
dritë e bardhë, dritë dielli
si një flakë, flakë pushke
flakë e kuqe mauzeri.

Përtej malesh, përtej fushash
zemra jonë fluturon,
përmes rojesh çan' e ikën
gjer në breg të detit Jon

ku na presin, ku na duan
gratë qyqë fillikat
(eh sa ditë e muaj shkuan,
sa gërvishtje në krevat!..)

Larg atdheut — Mos vajtoni
ne do vijmë përsëri

dhe në vdekshim do të thoni:
ranë, ranë për liri...

4

... Ikën vitet — thotë kënga
eh, sa vite kanë shkuar
flokët zbardhurë në tëmtha
bora kokën ka mbuluar.

Nëpër këngë shkrirë jetë
këngët plumba, këngët predha
këngët vezme me fishekë
kënduar nëpër beteja.

Nëpër dasma, nëpër festa
Ç’na kujtojnë ato vite...
(nga një këngë lindi vjersha
vjersha për vitet epike).

HEROINES

Kushtuar P. Kokëdhimës

Ti po vije nga luginat
fshati djegur e shkretuar
flaka qiellit. Ulérinin
shamizezat leshlëshuar.
Shtrëngon grushtin të goditësh,
rrëmben pushkën, lë kopenë
mbi armikun të vërvitesh,
do ta mbytësh, i bën benë.

Dhe del malit, Perso trime
mbi shkëmbinjtë ngre folenë:

Ecën me brigadën bashkë:
Yjet ballit xixëllojnë.
Yjet e brigadës gjashtë
errësirën e përshkojnë
shkrepin, ndizen, ndrijnë natën

posi flaka përmbi pushkë.
Ti marshon e s'e ndal hapin
mal më mal e fushë më fushë

Kudo pranë, o Perso trime
me shqiponjat zemërshpuzë.

Çan mes shtigjesh edhe s'lodhesh
gjëmbat këmbët seç t'i shpojnë
njolla gjaku mbi lëkurë
gjak e djersë seç pikon...
por ti ecën pa ndaluar
përmes zjarresh, mes llogoresh,
monopatesh gjarpëruar
përmes kreshtave shkëmboре

Dhe s'ndalon, moj Perso trime
Dhe s'ndalon, moj heroinë.

Netve zgjuar. Mbyll qepallat.
Një sy gjumë. Dielli digje
djersët rridhnin përmbi ballë
era heshtte, s'pipëtinte.
Duart t'i lidhën me pranga
Rrzëzë malit të Rogaçit
(ku të kapën ty gjermanët)
gurgullonte ujët shpatit,

tundte bishtin gjeraqina
dhe këndonte me cicërimë:

«Qëndro, trime Persefoni
mos u tund, moj heroinë!

Zemra jote s'kish të ndalur
pa liri, pa erë mali
shkriu plumbin, shkriu hekur.
Shkriu prangat, dogj litarin,
çau gjoksin, fluturoi
dhe u sul përmbi gjermanë
nëpër gryka fort ushtoi
«Para, shokë partizanë!»

Zemërzarra Persefoni
zemërzarra heroinë.

Ishe rritur mbi shkëmbinjtë
kishe fjetur nëpër male
ku kullotje dhentë, dhitë
ujë pije në cpithare
blegërimat në bregore
mes shkëmbinjve trëndelinën
shumë i doje, dimrit borën
ngricën, erën, suferinën

Se ishe lindur në stane
moj shqiponja partizane.

Ndaj s'të trëmbnin krismat, flakët,
ndaj s'të trëmbnin ty përrenjtë
ndaj s'të trëmbnin gjaku, plagët
ndaj kaloje mbi lumenjtë
përmes plumbash, copa predhash.
Si një zog që çan mes reve
krahëhapur mbi humnera
e zbrët poshtë lugareve

si një zog vërtet, o trime
Si një zog, o heroinë.

Erdhi përsëri pranvera
dhe bylbylat nisën këngën
majë malesh si përhera
gjith' barinjtë ngritën tëndën.
Tej traktori gjithë natën
lëron arat në luginë
sythat gjethe çelën prapë
gjethet tunden, fëshfërijnë

pëshpërijnë: «Persefoni,
heroinë» pëshpërijnë.

Të kërkojmë, je me neve
të thërrasim, na përgjigjesh
në të çiturre të qeve,
malit zbrët e malit ngjitesh.
Rrugësh, brigjesh e xhaderash

buzë mbrëmjes, në agimë
në kantiere në miniera
kudo pranë ti, o trime

Pranë nesh, o Persefoni
pranë nesh, o heroinë.

Ecim bashkë dorë për dore
nëpër shkrepë, nëpër male
mbi kurrizet me dëborë
ku barinjtë ndezin zjarre
përmes pyje bërdhash, pishash
përmes flakë vetëtimash
buzë detit, piramidash
mes rrufesh, mes bubullimash,

Gjithë bashkë, o Perso trime
me ne bashkë, o heroinë.

Vjen me neve në aksione.
Kudo shkojmë ne të rinjtë —
mbi maqina në kolonë
mbi tarracat, mbi shkëmbinjtë.
Çelin lule portokallet
zverdhin arat me grurë
ti nis këngën më të madhe
shteg më shteg e udhë mb'udhë

midis nesh, o Perso trime
në bregdet, në hekurudhë.

PËRMES VITEVE

(Poemë)

1

Mbrëmje.

Dola në bulevardet e gjera;
fletorkën me vargje braktisa
dhe dola.

Më grishi lëvizja
Më grishën parullat me neone

reklamat
ekspozitat

autobuset urbane

njerëzit që shëtisin
dhe lart që nga godinat e konviktit

zbrita:

Thith ajrin e freskët të mbrëmjes me ëndje
kundroj perëndimin e purpurtë
dhe qielin e pastër me yje e fishekzarë
dhe eci mes njerëzve

bri trotuareve.

Unë hyj në grumbullin e madh të njerëzve

dhe njerzit futen në qënjen time të vogël
e kështu ndjej që rritem

e rritem

si një trup vigan me mijëra duar
me mijëra këmbë
me mijëra sy
me mijëra zemra.

Po hym në qënien time të vogël gjithshka:
bisedat

rrezet

reklamat e filmave, teatrove e cirqeve
ndërsa mendimi rrëshqet ngadalë mes njerëzve
rrufeshëm kalon mbi kodra e brigje
dhe mbërthehet aty-këtu

përmes viteve...

2

Bulevardi plot...

nëna t  mplakura

baballarë tē thinjur

v  lez  r dhe motra t   qeshur

mbesa dhe nipër në karrockat e vogla

tē mitur.

Gérshetohen gjeneratat bisedat

mendimet.

Kjo dallgë njerëzish

si një dallgë e stuhishme
mbi brigjet e kreshpëruara të detit.

Keni dëgjuar për gjirin e Biskajës
për dallgët e tij të fuqishme?
Porse kjo dallgë sonte mbi këto bulevardë të gjera
 është më e fortë se dallgët e gjirit të Biskajës.
Mendimet e saj janë më të thella
 se ujërat në gjirin e Biskajës
Buzëqeshja e saj është më e bardhë
 se shkuma e valëve të Biskajës.

Në gjokset leshatore të këtyre njerëzve
plasën sa herë stuhitë e viteve.

Ndër shekuj kupa e qiellit
 si kupola e një katedraleje të madhe
qëndronte mbi kokë qëndronte mbi shpatulla
të gjyshërve tē nënave
 tē baballarëve.
Barrë e rëndë quell i errët

si dikur n  p  r mite...

Si dikur n   legjend  ...

Ekstremet e k  tij horizonti t   err  t
qarkonin nj   bot   t   vog  l
t   heshtur.

4

Shpesh   aheshin ret  .

Nj   p  ll  mb   qiel i kalt  r
nj   met  r.

Dhe aty k  tu ndizej nj   yll i zbet  .
Vezullonte nj     ast

pastaj, si meteor, k  putej
e humbiste n   k  t   pellg t   err  t
sikur t   binte diku n   humner  .
Kryengritjet ngriheshin e vendoseshin shkre-
pave...

Ndihej nj   krism  ,

nj   pushk   me strall.

Gj  monte r  nd   n   fillim

si gj  mim i thell  

pastaj krisma jehonte

p  rhapej n   shpate

e merrnin luginat

honet

përsëritez...

Përsëritez...

Dhe heshtte

ngelte pas jehona.

Nga krismat dhe nga baruti i djegur
dilte pak flakë

pak dritë

një rreze

rreze që dilte nga tytat

flakë që dilte nga krismat.

E prapë tytat qëndronin të ngritura
kërkonin të villnin më tepër flakë
që të jepnin më tepër dritë.

Gojët e tyre të pandryshkura
bluanin me dhëmbët e hekurt

errësirën e ditëve.

5

Dielli

tej në skaj të horizontit
ku dukeshin konturet e gungave të murme
ish fshehur e s'dukej.

Toka e ngrirë
pemët të zhveshura.

Mbi muskujt e fortë të gjyshërve
mbi shpatullat e gjera të baballarëve

qëndronin kullat e rënda të agallarëve
qëndronin kupolat e errëta të kishave.

6

Kjo ish bota e gjyshërve
botë e baballarëve
botë e nënave të mjera,
botë e andrallave.

Jetë e shkurtër
lot të hidhur
barrë e rëndë.

Drita ish një imazh
një iluzion
ajo duhej të ish e bardhë.
Dhe e bardha duhej të ish...
Kush mund ta kuptonte si ish e bardha?
Si dielli?
Po dielli?

Ai s'dukej
Ish fshehur mbas gungave të murme
në një perëndim të gjatë,
në një natë të gjatë.
Mbas manteleve të reve
në një dimër të gjatë.

Një natë e errët përpiu shumë breza;
si një hon i tmershëm

si një pus i thellë
i thithi pa parë ku dolën
pa ditur ku shkonin.

me një rrjetë të hekurt frëngjish
në kullat thatanike.

U ishin zënë sytë
ecnin në rrugë pa shigjeta
pa drejtime
pa drita.

Drejt jet s-vdekja.
Drejt vdekjes-jeta.

Bridhnin hordhitë e armiqve
mbi tokën e ftohtë shqiptare.
E mbi hordhitë e armiqve
hidheshin çetat, që zbrisnin nga malet.
Mbi topat gjigante
ngriheshin madhështore
pushkët me gjalmë.

Mbi telat me gjëmba majëmprehta
shtroheshin gunat e zeza me thekë.

E mbi telat
mbi gunat me thekë
përleshej turrshëm Jeta
...dhe Vdekja.

8

Për një çast qelli u bë shumë i rëndë
dhe ky çast zgjati shumë;
u ngjesh mbi kokët e baballarëve
si një helmetë vigane e hekurt
si një helmetë vigane e gjelbër
si një çizme e hekurt
e rëndë.

Mbi grunja topa të hekurt,
mbi xhadera kuadrate të gjelbra.
Buka po digjesh
uria gërrynte stomakun.

Gjuhë e egër.
Mesnatave të qeta çizmja e hekurt
trokonte rrugëve të kalldrëmta.
Kondaku i pushkës
binte mbi shpatullat e baballarëve.
Shpatullat u gërvishën
u gjakosën.
Dhimbja përshkoi zemrën
dhe grushtet u ngritën
dhe grushtet u tendosën.

Gjuha e egër kërkonte gjuhë të egër
krismat kërkonin krisma.

Një trakt u ngjit në rrugë...

Një trakt u ngjit në derë;

Trakti: — Partia.

Drita që do ndriste çdo

rrugicë të errët

flaka që do digjte

çdo perde të mjergullt.

9

Gjëmuan malet

ushtuan luginat.

Dhe liria e përgjakur fitores i buzëqeshi.

Majave filluan këngën gjeraqinat

Në ato ditë të bukura vjeshte.

• • • • • • • • • • • •

10

Ne ishim fëmijë,

po hynim në një'botë tjetër

në botën me diell,

në botën me dritë,

dhe dilnim nga bota e errët,

si celin filizat e rini.

te gielbér

mbi një trung të trashur nga vitet!

Mbi duart ton a mbinte e ardhmja
si një rrebesh i fuqishëm
mbi malet e zhveshura
Na shtriheshin aksione të vështirë përparrë
për të parë ditë të bukura
të qeshura.

Nga t'ja nisnim?
Monopate dhe shkëmbinj të thepisur
ura të hedhura n'erë
fshatra të djegura
toka të vithisura;
majë maleve endeshin retë,
endesh stuhia.

Nga një piramidë në tjetrën
kërcënohej tmerrshëm liria.
Në kisha

nën dritën e zbetë të qirinje me dyllë
priftërinjtë mprehnin kamat me dorëz t'ergjëndtë
dhe pushkët i nxirrnin nga bodrumet
i nxirrnin

të na binin mbas krahëve qentë...
Por pati një dorë të fuqishme Shqipëria
që s'mundën ta thyejnë tufanët
që s'mundën ta mposhtnin komplotet,
që s'mundi ta mposhtë tradhëtia:
si flamur nga beteja në betejë na printe

PARTIA.

Mbi shpatullat tonë
 rrodhën vitet të rënda,
 rrodhën vitet ngarkuar me vepra.
 Si një karvan mushkash
 në një shpat mali të pjerrët
 drejt një agimi të përflakur
 drejt mbrëmjesh të ndezura...

Rrodhën vitet
 'dhe na lanë mbi shpatulla vulën e kohës
 'dhe na lanë në duar kallot e forta.

Rrodhën vitet
 rrodhën pesëvjeçarët.
 Nga kongresi në kongres
 mblidhen delegatët
 ngnrenë gishtat lart
 dhe duket sikur ngnrenë oxhaqet
 Uzina e sodës
 Uzina e telit
 Uzina e traktorit
 Uzina e superfosfatit...

Dhe toka e etur
 e tharë
 e zhveshur

dhe toka e kripur nga rrjedha e djersës
me krehrin e flladit mëngjezeve të freskëta
kreh flokët e grurit të gjelbër.

Dhe hynë këto vite
në historinë e Shqipërisë
si vite të lavdishme
dhe ne bashkë me vitet
u rrjeshtuam në radhën e heronjve
të viteve të stuhishme.
Vite të hekurta
njerëz të hekurt.

12

Ecim këtë mbrëmje të madhe
në të gjerat bulevarde
dhe na hedh kjo mbrëmje
në marshimet partizane,
dhe na hedh kjo mbrëmje
në aksionet e mëdha ndërtimtare.
Përpara na shplekset rruga e gjatë nga shkuam
në këto vite të shkurtëra
në këto vite të zjarrrta
dhe fishekzaret bien mbi supe
si yje me dritë të artë.

Eci dhe unë mes njerëzve

hyj në qënjen e tyre të madhe
dhe njerzit futen në qënjen time të vogël
e kështu ndjej që rritem e rritem
si një trup vigan më mijëra duar
me mijëra këmbë
me mijëra sy
me mijëra zemra.

Hyn në qënjen time të vogël gjithshka:

Hapi i njerëzve

bisedat dhe buzëqeshjet e tyre

flamujtë

fishekzaret

reklamat e filmave, teatrove e cirqeve

ndërsa mendimi rrëshqet ngadalë mes njerëzve

rrufeshëm kalon në shtigje të reja

dhe mbërthehet në shkëlqimin e ardhshëm

të viteve...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Marshim	3
Pianistes me uniformë ushtarake	5
Të shtatë.	6
Simfonia e jetës sonë	8
Sonja.	10
Ti ngele në kujtesën time	12
Mersini.	14
Te barinjtë	17
Pentagramet e metaltë	19
Nata e Shën Bartolemeut	20
Në uzinën e traktorëve	22
Parti.	24
Vajza e 180 detaleteve.	25
Fshatarët e mi	27
Këngëtori.	29
Perënditë në agoni	33
Asaj nate	35
Minarja e xhamisë	37
Vargjet e mia	38
Sa të dua ty, moj nëna ime.	39
Xhordano Brunos	41
Mendime në vendroje	42
Mbrëmje.	44
Shoferit.	45
Në retinën e syve	46
Në shtëpinë e pushimit	47
Kënga e të internuarve	48
Heroinës.	53
Përmes viteve	58

55800



Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtypur NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970